

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6291
E enjte, 15 prill 2021
çmimi 0.40 €

MAPL-ja ndan rreth 4.35 milionë euro për komunat



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KËSHILLI I KRYETARËVE I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS (AAK) KA MBAJTUR MBLEDHJE, NË TË CILËN ËSHTË DISKUTUAR PËR MASAT KUNDËR COVIDIT

KËRKOHET HEQJA E ORËS POLICORE DHE HAPJA E GASTRONOMISË



Kryetarët e komunave të Kosovës kanë kërkuar lehtësimin e masave kundër Covidit. Në mbledhjen e këshillit të kryetarëve të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) ata kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës heqjen e orës policore dhe hapjen e gastronomisë. Sipas tyre, pas hapjes gastronomisë duhet t'i zbatohet udhëzimet për distancën fizike edhe nëpërmjet tavolinave

AKTUALE



KURTI: DO TË MARRË FUND EPOKA E PARULLËS 'RROGA E VOGËL, FITIMI I MADH'

DELIU-KODRA: QEVERIA KURTI PO E MOHON HISTORINË E RE TË KOSOVËS

PËR TRI JAVË 532 MËSIMDHËNËS DHE 712 NXËNËS TË INFEKTUAR ME COVID

EKONOMI



OAK-u KËRKON PËRKRAHJE PËR LIGJIN PËR PUSHIMIN E LEHONISË DHE ARKËN "PATRIOT"

DOGANA KAP MBI 28 000 MIJË EURO NË NJË AUTOMJET

SPORT

GRABOVCI: KU MBETËN RRETH 500 MIJË EURO PËR STADIUMIN 'SHAHIN HAXHIISLAMI' NË PEJË?

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ NGA QEVERIA KURTI PRESIM VETËM RETORIKË

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka thënë se nuk ka ndonjë pritje të madhe nga qeveria Kurti. Në një bisedë për "Epokën e re", ai ka thënë se nga kjo qeveri mund të pritët vetëm retorikë. Sipas tij, qeveria deri më tani nuk ka bërë asnjë veprim në dobi të interesit qytetar për çfarë e ka marrë besimin e qytetarëve më 14 shkurt. Lekaj ka thënë se edhe në këto pak ditë të qeverisjes po vërehet që qytetarët veçse janë zhgënjyer me këtë qeveri



POLICA ARRESTON 25 PERSONA PËR VEPRIMTARI KRIMINALE



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Fuqitë perëndimore kritikojnë Iranin

VJENË, 14 PRILL - Fuqitë perëndimore e kanë pritur me shqetësim të lartë njoftimin e Iranit se do të fillojë pasurimin e uraniumit deri në 60 për qind të pastërtisë.

Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania janë palë në një marrëveshje bërthamore me Iranin, e cila ishte arritur në vitin 2015, por nga e cila tre vjet më vonë janë tërhequr Shtetet e Bashkuara.

Edhe Rusia dhe Kina janë pjesë e marrëveshjes. "Njoftimi i rrezikshëm i Iranit është në kundërshtim me frymën konstruktive dhe mirëbesimin e përpjekjeve të vazhdueshme për ta ringjallur marrëveshjen e vitit 2015", thanë tri vendet perëndimore përmes një deklarate të përbashkët.

Javën e kaluar në Vjenë, Irani dhe fuqitë botërore zhvilluan ato që ata i përshkruan si

bisedime "konstruktive", në përpjekje për t'i rikthyer Uashingtonin dhe Teheranin që ta zbatojnë marrëveshjen bërthamore, e njohur si Plani i Përbashkët Gjithëpërfshirës i Veprimt (JCPOA).

Bisedimet në Vjenë të Austrisë pritet të vazhdojnë më 15 prill.

Pavarësisht nga nismat diplomatike, Irani tha më 14 prill se do të fillojë prodhimin e uraniumit të pasuruar me pastërti 60 për qind deri në javën e ardhshme. Njoftimi pasoi një sulm të pretenduar në uzinën kryesore bërthamore në Natanz. Teherani ka fajësuar Izraelin për sulmin.

Shtëpia e Bardhë ka thënë se mbetet e përkushtuar në bisedimet me Iranin.

Sipas marrëveshjes bërthamore, Irani ishte zotuar ta mbante pasurimin e uraniumit në 3.67 për qind.



Ish-presidenti amerikan Donald Trump pas tërheqjes së ShBA-së nga marrëveshja pati thënë se ajo ishte e negociuar keq dhe se i mundësonte Teheranit të posedojë armë bërthamore. Trump vendosi sanksione të ashpra ndaj Iranit. Tash, për ta nisur zbatimin e marrëveshjes, Teherani kërkon që fillimisht të hiqen këto

sanksione nga ana e administratës së presidentit amerikan, Joe Biden.

Kohët e fundit Teherani ka pasuruar uraniumin deri në 20 për qind.

Pasurimi i uraniumit në 60 për qind do të ishte niveli më i lartë i arritur nga programi bërthamor i Iranit, megjithëse ende nuk ka pastërtinë prej 90-

përqindësh të nevojshme për përdorim ushtarak.

Teherani ka mohuar vazhdimisht se po synon të posedojë armë bërthamore duke thënë se ambiciet e tij bërthamore janë thjesht civile. Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania thanë se vendimi i Teheranit përbënte një hap të rëndësishëm për prodhimin e një arme bërthamore.

Marrëveshja bërthamore e vitit 2015 është kundërshtuar prej kohësh nga Izraeli. "Ne nuk duhet t'i kthehemi marrëveshjes së rrezikshme bërthamore me Iranin, sepse një Iran bërthamor është një kërcënim ekzistencial për shtetin e Izraelit dhe një kërcënim i madh për sigurinë e të gjithë botës", ka thënë më herët kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu.

Blinkeni: Është koha të tërhiqemi nga Afganistani

UASHINGTON, 14 PRILL - Uashingtoni do të punojë për së afërmi me aleatët e NATO-s për një tërheqje të koordinuar nga Afganistani, ka thënë sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken. "Së bashku kemi arritur qëllimet dhe tash është koha për t'i kthyer forcat tona", tha Blinken para bisedimeve me partnerët e NATO-s në Bruksel.

Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, do të njoftojë zyrtarisht të mërkurën, se Uashingtoni do t'i tërheqë 2 500 trupat e tij të mbetura nga Afganistani deri



më 11 shtator. Kjo periudhë përkon me 20-vjetorin e fillimit të sulmeve të ShBA-së në Irak.

Më 2001 forcat e udhëhequra nga ShBA-ja kanë pushtuar Afganistanin dhe kanë rrëzuar

regjimin e talibanëve për shkak të strehimit të Al-Kaidës, grupit ekstremist, i cili ka qenë mbrapa sulmeve terroriste të 11 shtatorit në tokën amerikane.

Gjatë takimit në Bruksel, partnerët e NATO-s pritet të bien dakord që t'i japin fund misionit të aleancës në Irak, në të njëjtën kohë kur largohet fuqia ushtarake kryesore, ShBA-ja.

NATO ka 9 600 trupa në Irak. "Së bashku, ne shkuam për t'u siguruar që Afganistani nuk do të bëhet përsëri një strehë për terroristët që mund ta

sulmonin ndonjërin prej nesh", ka thënë Blinken.

Pavarësisht prej tërheqjes, Blinken këmbënguli se "angazhimi për Afganistanin do të vazhdojë".

Talibanët kanë kërcënuar se do t'i rikthejnë sulmet kundër trupave të huaja në Afganistan, nëse ato nuk largohen deri më 1 maj.

Ky afat është përcaktuar në marrëveshjen e arritur më 2020 në mes të talibanëve dhe administratës së ish-presidentit amerikan Donald Trump për paqe në Afganistan.

Gjermania: Rusia po synon të provokojë me praninë ushtarake në kufi me Ukrainën

BERLIN, 14 PRILL - Gjermania ka akuzuar Rusinë se po synon të provokojë përmes rritjes së prezencës ushtarake në Gadishullin e pushtuar të Krimesë dhe në pjesën e kufirit me Ukrainën, si dhe ka hedhur poshtë pretendimin e Moskës se është duke iu përgjigjur kërcënimeve nga NATO-ja. "Bindja ime është se pala ruse është duke tentuar gjithçka për të nxitur reagim", ka thënë ministrja gjermane e Mbrojtjes Annegret Kramp-Karrenbauer për televizionin publik ARD.

"Bashkë me Ukrainën ne nuk do të hyjmë në këtë lojë", ka thënë ajo, duke shtuar se është e qartë që Rusia "është duke

pritur për ndonjë lëvizje, le të themi nga NATO-ja, për të pasur një pretekst që t'i vazhdojë veprimet e veta".

Disa fotografi, incizime dhe të dhëna të tjera sugjerojnë për lëvizje të mëdha të njësiteve ushtarake ruse drejt apo afër kufirit me Ukrainën dhe Krimesën e aneksuar nga Moska më 2014, gjë që ka rritur shqetësimet se Rusia është duke u përgatitur për t'i dërguar forcat në Ukrainë.

Ukraina dhe Perëndimi po ashtu fajësojnë separatistët e përkrahur nga Rusia, që zotërojnë rajonet lindore të Donetskut dhe Luhanskut, për përshkallëzimin e fundit të

situatës, derisa Moska ka drejtuar gishtin te Kievi.

Kramp-Karrenbauer, po ashtu, ka hedhur dyshime në pretendimet e Moskës se prania në rritje ushtarake e Moskës është përgjigje ndaj "kërcënimeve" nga aleanca transatlantike e NATO-s. "Nëse kjo është manovër, siç thotë pala ruse, ekzistojnë procedura ndërkombëtare përmes të cilave një palë mund të krijojë transparencë dhe besim", ka thënë ajo.

Rusia ka aneksuar Gadishullin e Krimesë nga Ukraina në mars të vitit 2014.

Moska, po ashtu, përkrah separatistët në luftën kundër



Qeverisë ukrainase, në të cilën janë vrarë më shumë se 13 000 persona në lindje të Ukrainës që nga viti 2014. Meqë tensionet janë në rritje e sipër, presidenti amerikan Joe Biden i ka bërë

thirrje të martën homologut të tij rus, Vladimir Putin, që të marrë masa për t'i ulur tensionet me Kievin dhe ka propozuar një samit në mes të dy liderëve, në një shtet të tretë.

KËSHILLI I KRYETARËVE I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS (AAK) KA MBAJTUR MBLEDHJE, NË TË CILËN ËSHTË DISKUTUAR PËR MASAT KUNDËR COVIDIT

Kërkohet heqja e orës policore dhe hapja e gastronomisë

Kryetarët e komunave të Kosovës kanë kërkuar lehtësimin e masave kundër Covidit. Në mbledhjen e këshillit të kryetarëve të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) ata kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës heqjen e orës policore dhe hapjen e gastronomisë. Sipas tyre, pas hapjes gastronomisë duhet t'i zbatohet udhëzimet për distancën fizike edhe nëpërmjet tavolinave



fundit të përkrahjes ekonomike dhe që të fillohet me një pako të re përkrahëse. Gjithashtu, komunat kanë bërë thirrje për bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve në mes të nivelit qendror dhe lokal për ruajtjen e shëndetit publik dhe ekonomik dhe që të fuqizohet bashkëpunimi në mes të inspektoratit qendror dhe atij lokal për zbatim të masave në mënyrë që të ruhet shëndeti publik.

Regjistrohen edhe 14 viktima dhe 701 raste të reja me Covid-19

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit

kanë ndërruar jetë edhe 14 persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Po ashtu, IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 737 persona dhe janë paraqitur 701 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR, si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT, janë testuar gjithsej 4 557 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 701 raste pozitive", është thënë në njoftimin e këtij instituti, duke treguar edhe moshën e të vdekurve. "Brenda 24 orëve janë raportuar 14 raste të vdekjes me SARS CoV-2

pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Pejë 2 raste (81, 78 vjeç), Prishtinë 2 raste (91, 79 vjeç), Prizren 2 raste (80, 68 vjeç), Viti 2 raste (73, 69 vjeç), Gjilan 1 rast (74 vjeç), Klinë 1 rast (80 vjeç), Mitrovicë 1 rast (75 vjeç), Shtërpcë 1 rast (62 vjeç), Skenderaj 1 rast (65 vjeç), Suharekë 1 rast (68 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 99.536 raste nga 486.970 persona të dyshimta në virusin SARS-CoV-2 dhe 2.022 raste të vdekjes", ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas IKShPK-së, gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 737 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 84 328 raste, kurse numri i rasteve aktive është 13 186. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 157 raste, Gjilan 84 raste, Mitrovicë 59 raste, Pejë 51 raste, Ferizaj 46 raste, Vushtrri 45 raste, Gjakovë 44 raste, Prizren 28 raste, Skenderaj 28 raste, Fushë Kosovë 22 raste, Lipjan 21 raste, Podujevë 20 raste, Kaçanik 12 raste, Viti 11 raste, Obiliq 10 raste, Suharekë 10 raste, Drenas 8 raste, Shtime 7 raste, Kamenicë 6 raste, Klinë 6 raste, Malishevë 5 raste, Rahovec 5 raste, Istog 4 raste, Junik 4 raste, Deçan 3 raste, Dragash 2 raste, Hani i Elezit 2 raste dhe Klokot 1 rast", ka njoftuar IKShPK-ja.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 PRILL - Kryetarët e Komunave të Kosovës kanë kërkuar heqjen e orës policore dhe hapjen e gastronomisë. Në takimin e këshillit të kryetarëve në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës ata kanë diskutuar për situatën pandemike nëpër komuna me virusin Covid-19. Duke diskutuar për masat e aktuale kundër Covidit, ata kanë vlerësuar se këto masa duhet të hiqen pas 18 prillit kur skadon edhe afati i tyre. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Imri Ahmeti, ka thënë se ka munguar komunikimi i mirëfilltë para këtyre masave mes nivelit qendror dhe atij lokal. Ai ka bërë me dije se qëllimi i këtij takimi ka qenë vlerësimi i komunave për

masat, efektet e tyre dhe hapat e ardhshëm në këtë drejtim. Në fund, kryetarët e komunave janë marrë vesh për rekomandimet e pushtetit lokal ndaj pushtetit qendror lidhur me situatën pandemike dhe masat e reja në këtë drejtim dhe, në anën tjetër, respektimin e masave nga ana e qytetarëve.

Shtatë rekomandimet e komunave janë që qeveria të ketë prioritet vaksinimin e popullatës, komunat kërkojnë heqjen e orës policore, rekomandojnë dhe kërkojnë që masat ndaj gastronomisë të tërhiqen dhe kërkojnë që gastronomia t'i zbatohet udhëzimet për distancën fizike edhe përmes tavolinave, komunat kërkojnë që të amandamentohet Ligji mbi Pandeminë, po ashtu komunat kërkojnë nga qeveria zbatimin e pakos së

Polica arreston 25 persona për veprimtari kriminale

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 PRILL - Policia e Kosovës (PK), në këtë rast Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar, e asistuar edhe nga njësitë e tjera policore, pas hetimeve disamujore të realizuara fillimisht në vitin 2020, të cilat kanë vazhduar deri më 14 prill të vitit 2021, ka arrestuar njëzet e pesë (25) persona të dyshuar. Ata janë arrestuar mbi dyshimin e bazuar për përfshirje në veprimtari kriminale të kimit të organizuar, përfshirë në vepra penale: "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse". Policia e Kosovës ka njoftuar se

operacionet policore janë realizuar me urdhëresë të organeve të drejtësisë, e që kanë përfshirë disa lokacione, konkretisht Prishtinën, Gjilanin, Ferizajn dhe Mitrovicën e Jugut, ku gjatë kontrollit të disa shtëpive dhe objekteve përcjellëse në të dy operacionet, në cilësi të provave materiale janë gjetur dhe sekuestruar tetë armë të gjata të llojeve të ndryshme, trembëdhjetë armë të vogla revole, dy karikatorë, 1 493 municione të kalibrave të ndryshme, pjesë të ndryshme të armëve, pajisje për pastrimin e armëve, dy leje për armë, dy vetura, një palë dylbi, njëzet e një telefona celularë, dy mijë euro dhe një fletore me shënime. "Nga njëzet e pesë (25) personat e arrestuar në të dy operacionet policore, vlen

të potencohet se dymbëdhjetë prej tyre janë arrestuar në vitin 2020, të cilët me vendim të prokurorëve kompetentë janë dërguar në mbajtje, përderisa në operacionin policor të realizuar sot në orët e hershme të mëngjesit janë arrestuar trembëdhjetë persona, prej tyre shtatë persona me vendim të prokurorit janë dërguar në mbajtje, përderisa gjashtë persona janë liruar në procedurë të rregullt. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë ligjore, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, parandalimin e veprimtarive kriminale dhe sjelljen para organeve të drejtësisë të personave të dyshuar që bien në kundërshtim me ligjin", ka njoftuar Policia e Kosovës.





FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

Nga qeveria Kurti presim vetëm retorikë

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka thënë se nuk ka ndonjë pritje të madhe nga qeveria Kurti. Në një bisedë për "Epokën e re", ai ka thënë se nga kjo qeveri mund të pritët vetëm retorikë. Sipas tij, qeveria deri më tani nuk ka bërë asnjë veprim në dobi të interesit qytetar për çfarë e ka marrë besimin e qytetarëve më 14 shkurt. Lekaj ka thënë se edhe në këto pak ditë të qeverisjes po vërehet që qytetarët veçse janë zhgënjyer me këtë qeveri

qeveri nuk presim ndonjë sukses madhor në qeverisje përveç retorikës boshe. Edhe në këto pak ditë qeverisjeje tanimë qytetarët veçse janë zhgënjyer me këtë qeveri, e cila nuk e ka prioritet luftimin e pandemisë dhe zhvillimin ekonomik, por pjesëmarrjen në zgjedhjet në Shqipëri", ka thënë Lekaj.

Lekaj.

Nënkryetari i AAK-së ka kritikuar qeverinë edhe për masat e reja kundër Covidit. Lekaj ka bërë me dije se me këto masa do të hapet rruga për shpenzim të parasë nga ana e qytetarëve në vendet e rajonit. "Ne si AAK që në fillim e kemi paralajmëruar qeverinë që me këto masa vetëm se do të hapet rruga për shpenzim të parasë të qytetarëve në vendet e rajonit. Kjo u vërtetua edhe këtë fundjavë, kur mbi 28 mijë qytetarë të Kosovës kaluan kufirin me Shqipërinë, duke shpenzuar të hollat e tyre jashtë vendit, ndërkohë që shumë biznese në vendin tonë janë mbyllur dhe rrezikojnë falimentimin", ka theksuar Pal Lekaj, nënkryetar i AAK-së.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

Prishtinë, 14 prill - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka kritikuar qeverinë Kurti për mungesë të vendimeve në këto tri javë të qeverisjes. Ai ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se deri më tani kjo qeveri

nuk ka bërë asnjë veprim në dobi të interesit qytetar. Sipas Lekajt, të vetmin vendim që ka marrë kjo qeveri është karantinimi parcial i vendit. "Jemi dëshmitarë që deri më tani kjo qeveri nuk ka bërë asnjë veprim në dobi të interesit qytetar për çfarë e ka marrë besimin e qytetarëve. Të vetmin vendim që e ka marrë është

karantinimi parcial, i cili u vërtetua që është i paefektshëm dhe që e dëmton edhe më shumë sektorin e gastronomisë", ka thënë Lekaj. Ai ka deklaruar se nuk ka ndonjë pritje të madhe nga qeveria e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti. Sipas Lekajt, prej kësaj qeverie mund të pritët vetëm retorikë boshe. "Nga kjo

Kurti: Do të marrë fund epoka e parullës 'Rroga e vogël, fitimi i madh'

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka folur për miratimin e konceptdokumentit për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. Kurti nëpërmjet një shkrimi publikuar në "Facebook" ka shkruar se në zgjedhjet e 14 shkurtit kanë premtuar se do ta luftojnë korrupsionin dhe krimin si dhe do ta konfiskojnë pasurinë në mënyrë të paligjshme



EPOKA ERE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka folur të mërkurën për miratimin e konceptdokumentit për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. "Në zgjedhjet e 14 shkurtit ne kemi premtuar se do t'i luftojmë korrupsionin dhe krimin dhe do ta konfiskojmë pasurinë e krijuar në mënyrë të paligjshme. Dje kemi filluar pikërisht këtë. Konceptdokumenti që kaluam është hapi i parë drejt ligjit të ri për konfiskimin e pasurisë së paligjshme e të pajustificueshme, prandaj edhe dua t'ju informoj për përmbajtjen e tij, duke filluar nga përkufizimi i pasurisë së paligjshme", ka thënë Kurti përmes një mesazhi të ndarë në rrjetin social "Facebook".

Ai ka thënë se në kuptimin e ngushtë, pasuria e paligjshme është çdo pasuri që është fituar në rrugë joligjore, por në një përkufizim më të gjerë, pasuri e paligjshme është çdo pasuri e

cila nuk arsyetohet. "Në Kosovë, për më shumë se dy dekada, në masë të madhe ka sunduar paligjshmëria, herë në mungesë të ligjeve e më shumë në mungesë të zbatimit të tyre. Zbrazëtira ligjore dhe joefikasiteti i organeve të drejtësisë ka krijuar hapësirë për rritje të kriminalitetit dhe një kulturë të pandëshkueshmërisë ku ata që kanë pasur qasje në buxhetin e shtetit e kanë keqpërdorur atë për të përfituar personalisht. Rrjedhimisht shumë zyrtarë të lartë, e të tjerë të mesëm të lidhur me ta, kanë krijuar pasuri marramendëse duke keqpërdorur taksat e qytetarëve", ka thënë kryeministri Kurti.

Ai ka bërë me dije se deri tani konfiskimi i pasurisë së paligjshme është rregulluar përmes tri shtyllave: Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. "Korniza ligjore e

tanishme parasheh ekzistimin e aktgjykimit dënues si element i domosdoshëm për t'i hapur rrugë konfiskimit të pasurisë. Një praktikë e tillë është konsideruar e padobishme dhe joefikase. Vetëm në gjashtë vjetët e fundit sekuestrimet kapin vlerën e 180 milionë euro, ndërsa konfiskimet vetëm 3.5 milionë euro. Kurse edhe pas kalimit të më shumë se një viti prej hyrjes në fuqi të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, ekziston vetëm një rast i identifikuar i zbatimit të tij në praktikë. Vetëm një rast. Ajo që kemi parë është hezitimi i organeve të rendit për ta ndjekur pasurinë e paligjshme, aktakuza jo mirë të përgatitura dhe një zvarritje e gjatë e proceseve gjyqësore që ka bërë që shumë lëndë të

parashkruhen dhe, si rrjedhojë, edhe të humbet mundësia për konfiskim", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se ajo që kemi deri tash është një kod penal që nuk mjafton, ligje që nuk adresojnë dhe strategji që nuk kanë dhënë rezultat. "Vendi ynë është i vogël dhe i varfër, por qytetarët tanë janë të ndershëm e të përgjegjshëm dhe duan një shtet të drejtë dhe të barabartë. Shteti juaj me qeverisjen tonë e tuajën duhet t'i japë fund e do t'i japë fund epokës së deritanishme ku dominonte parulla: 'Rroga e vogël, fitimi i madh!'. Askush nga ne nuk mund të shpenzojë pasurinë që nuk e fiton. Në jetën e përditshme ne skuqemi kur na bie zori që të kërkojmë diçka hua, dhe bëjmë gjithçka që të jetojmë brenda mundësive

tona, nga rroga dhe puna jonë e ndershme. Por, ju e dini se për shumë kohë ata që kishin duart në buxhetin e shtetit nuk ju mjaftonin pagat e privilegjet, por përvetësuan pasuri që nuk e justifikojnë dot. Kjo nuk është e drejtë dhe as e ndershme, prandaj edhe duhet të veprimë që të krijojmë një shtet ku secili merr fitimin që meriton dhe paguan detyrimin që i takon", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se pasuria e fituar në mënyrë të paligjshme kurrë nuk është as private e as e ligjshme sepse ajo kurrë nuk është fituar. "Qeveria do të veprojë në pajtim me zotimet e dhëna para qytetarëve e në përputhje me praktikën më të mira për të ndërtuar një shtet të drejtë me mundësi dhe shanse të barabarta për të gjithë", ka thënë Kurti.

Deliu-Kodra: Qeveria Kurti po e mohon historinë e re të Kosovës

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 PRILL - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerta Deliu-Kodra, ka mbajtur të mërkurën konferencë për media, në të cilën ka kritikuar qasjen e qeverisë Kurti dhe të presidentes për ta mohuar historinë më të re të Kosovës, trashëgiminë politike dhe vlerat kombëtare.

Deliu-Kodra ka theksuar se ky pushtet i ri udhëhequr nga Vetëvendosja, i cili po mendon që gjithçka në Kosovë fillon me ta, ka hequr dorë nga politika e jashtme e Kosovës, e ka suspenduar atë, duke e shndërruar në politikë të brendshme dhe në mekanizëm të thashethemeve. "Ky pushtet është larguar nga politika e jashtme e koordinuar me miqtë tanë perëndimorë dhe është



përafuar me narracionin e Rusisë dhe Serbisë. Imazhi që këta qeveritarë, këta mohues të shtetit tonë janë duke portretizuar nëpër botë për vendin, është një Kosovë pa histori, pa shpalljen e

pavarësisë, pa Kosovën e njohur nga 117 shtete, pa Kosovën e anëtarësuar në mbi 60 organizata ndërkombëtare, pa UÇK-në, pa luftën tonë çlirimtare, pa sakrificat, pa suksese dhe pa vlera shtetërore.

Ministrja e Jashtme e Kosovës, e verbuar nga inatet politike, nuk tha asnjë fjalë për njohjen e Kosovës nga Izraeli. Këshilli i Sigurimit është terren për afirmim të shtetësisë së Kosovës dhe jo përkrahje të narracionit

rus dhe serb për Kosovën. Pa ia kërkuar askush, Donika Gërvalla-Schwarz foli zi e terr në sytë e botës se si Kosova është e pushtuar nga krimi dhe korrupsioni", ka thënë ajo.

Deliu-Kodra, duke thënë se fjalimi i djeshëm i Gërvallës shënoi një ditë turpi për Kosovën që, fatkeqësisht, u orkestrua nga qeveria e saj në Prishtinë, ka theksuar se çdo e arritur e Kosovës në politikën e jashtme është meritë e miqve ndërkombëtarë në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Nëse ata përpiqen t'i mohojnë të arriturat e PDK-së për shtetndërtimin e Kosovës, të paktën të mos sillen naivë duke mohuar meritat e qytetarëve, miqve ndërkombëtarë dhe përqafojnë pa vetëdije narracionin serb dhe rus në marrëdhëniet ndërkombëtare", ka thënë Deliu-Kodra.

633 raste aktive me Covid-19 në Gjilan, apelohe për kujdes të shtuar

GJILAN, 14 PRILL (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan, nën udhëheqjen e nënkryetarit Arbër Ismajli, ka mbajtur takim për vlerësimin e situatës për dy ditët e fundit. Ismajli ka njoftuar se aktualisht 82

qytetarë të Gjilanit janë duke u trajtuar në Spitalin e Përgjithshëm, 64 prej të cilëve me oksigjeno-terapi, derisa ka theksuar se 633 raste janë aktive. Ai ka apeluar të gjithë qytetarët që t'i respektojnë masat kundër përhapjes së Covid-19. Pasqyra e përgjithshme në

Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: nga 19 109 mostra, 5 795 kanë rezultuar pozitivë, 5 036 janë shëruar, 127 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 633 raste janë aktive, të hospitalizuara me Covid janë 82 persona dhe 64 prej të cilëve me oksigjeno-terapi.



Bahtiri ofron përkrahje për hapjen e studios rajonale të RTK-së në rajonin e Mitrovicës



MITROVICË, 14 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës, Agim Bahtiri, ka pritur në takim Hirashima Jun dhe Hashimoto Keiichi, përfaqësues të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) si dhe zëvendësrektorin e përgjithshëm të RTK-së, Lorik Arifaj. Përfaqësuesi i JICA-s, Hirashima Jun, e ka njoftuar kryetarin Bahtiri për memorandumimin e bashkëpunimit në mes të JICA dhe televizionit publik RTK, ku parashihet ngritja e dy studiove rajonale, njëra në Mitrovicë dhe tjetra në Prizren, me ç'rast u kërkua nga Komuna e Mitrovicës që të sigurojë një

hapësirë komunale prej 200 m2 për nevojat e studios rajonale të RTK-së në rajonin e Mitrovicës. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka falënderuar shtetin e Japonisë për ndihmën e dhënë shtetit të Kosovës për realizimin e shumë projekteve duke ndikuar kështu në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve. Ndërsa lidhur me kërkesën e RTK-së dhe JICA-s për t'i mbështetur për ofrimin e një objekti për nevojat e studios rajonale të RTK-së në Mitrovicë, kryetari Bahtiri ka ofruar mbështetjen e tij për implementim të këtij projekti pasi të shqyrtohen mundësitë ligjore dhe të vlerësohen kapacitetet aktuale komunale.

Muharremaj: Në zgjedhjet e tetorit do të fitoj sërish bindshëm

SUHAREKË, 14 PRILL - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka thënë se vaksinimi kundër Covid-19 në këtë komunë ka filluar nga java e kaluar. "Përparësi në vaksinim kanë punëtorët shëndetësorë, 120 vakcina i kishim për ata, edhe pse disa mjekë janë duke hezituuar për t'u vaksinuar. Ndërsa para disa ditëve kemi pranuar edhe 300 vakcina, të cilat do të jenë për personat mbi 85 vjeç si dhe për të moshuarit në shtëpinë e pleqve", ka thënë ai, duke bërë me dije se të mërkurën ka filluar edhe vaksinimi të shtëpia e të moshuarve. "Mbi 30 qytetarë që janë në atë shtëpi do të jenë pjesë e këtij

procesi. Kam kërkuar që vaksinimi të fillojë edhe për mësuesit, policët, stafin komunal dhe zjarrfikësit. Numri i vaksinave në Komunën e Suharekës është i vogël", ka thënë Muharremaj në "Klan Kosova". Ai ka bërë me dije se do të kandidojë sërish në zgjedhjet lokale të këtij viti që pritet të mbahen në muajin tetor. "Në zgjedhjet e tetorit do të fitojë bindshëm, jo që dua unë, por duan qytetarët e Kosovës. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në zgjedhjet e ardhshme do t'i fitojë 10 komuna. Ne jemi duke punuar në këtë aspekt, nuk jemi duke pushuar", ka thënë Muharremaj.



KFOR-i italian dhuron donacion për kabinetin e informatikës në shkollën e fshatit Mushnikovë të Prizrenit

Prizren, 14 prill (ER) - KFOR-i italian ka pajisur kabinetin e informatikës në shkollën e fshatit Mushnikovë të Prizrenit, të cilin komuna e ka rinovuar në vitin 2019, ku edhe ka krijuar pesë hapësira të reja për kabinate në këtë

shkollë. Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka falënderuar KFOR-in italian për donacionin, duke shprehur që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Përveç

kësaj, nxënësit e kësaj shkolle i kemi pajisur edhe me dollapë dhe i kemi furnizuar me shujta, ndërkaq nga sot do t'i gëzojnë edhe 20 kompjuterë dhe dy laptopë, të dhuruar nga KFOR-i italian", ka thënë Haskuka.



Për tri javë, 532 mësimdhënës dhe 712 nxënës të infektuar me Covid

PRISHTINË, 14 PRILL - Në një periudhë trijavëshe, përkatësisht nga 15 marsi deri më 2 prill, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 532 mësimdhënës dhe 712 nxënës të infektuar me Covid. Këto të dhëna janë bërë me dije nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. "Këto të dhëna merren nga Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), ndërsa të dhënat e sakta i ka vetëm Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK)", është thënë në një përgjigje të kabinetit të ministres së Arsimit dhe Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, për "Radion Evropa e Lirë".

Në institucionet e arsimit parauniversitar dhe atij universitar në Kosovë, aktiviteti mësimor, nga 12 prilli, është duke u zhvilluar në formatin online. Ky vendim është marrë nga Qeveria e Kosovës me qëllim të luftimit të koronavirusit.

Nxënësit nga klasat një deri në pesë aktivitetin mësimor po e zhvillojnë me prani fizike në shkolla, ndërkaq institucionet parashkollë do ta vazhdojnë aktivitetin normalisht, duke i respektuar masat dhe rekomandimet kundër Covid-19.

Mësimdhënësit në Kosovë janë duke kërkuar nga institucionet shëndetësore që të futen në



listën me prioritet për vaksinimin kundër Covid-19 për shkak të, siç thonë ata, rrezikshmërisë për t'u infektuar, por edhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor në nivel të

duhur.

Në përgjigje të Ministrisë së Arsimit është thënë se "ministria Nagavci e ka bërë të qartë se kjo do të trajtohet me prioritet dhe për këtë çështje është në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë. Do të shikohet që prioritet t'u kushtohet mësimdhënësve me sëmundje kronike dhe atyre në moshë më të shtyrë".

Sa i përket vendimit rreth mënyrës se si do të mbahet mësimi javën e ardhshme, ministria Nagavci ka thënë se vendimi do të merret varësisht nga rekomandimet e organeve kompetente, por edhe në pajtim me të gjitha drejtoritë komunale.

Osmani: 14 prilli nga sot e tutje do të shënohet si Dita e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës

PRISHTINË, 14 PRILL (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim deputeten Vasfije Krasniqi, e mbijetuar e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. "14 prilli për dikë mund të jetë ditë e një përvjetori të rëndësishëm, datë e lindjes, ditë e parë e punës, e për dikë thjesht një ditë e zakonshme. Por, për Vasfije Krasniqin mbetet përherë data kur jeta e saj ndryshoi përgjithmonë. Atë ditë të vitit 1999 ajo u rrëmbye me forcë dhe u dhunua në mënyrë barbare nga forcat serbe. Në këtë ditë, barra e luftës për të ka marrë kuptim tjetër, sepse u shtua aq shumë në peshë e u bë

përjetësisht e pashlyeshme", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook".

Osmani ka thënë se me Krasniqin në këtë takim u pajtuan që 14 prilli nga sot e tutje, nën përkujdesjen e presidentes së Republikës së Kosovës, të shënohet si Dita e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës së fundit në Kosovë. "Po ashtu, i premtova që në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës do të angazhohemi për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e duhur institucionalë për ta shndërruar datën 14 prill në një ditë të shënuar edhe me ligj", ka shkruar Osmani.



MAPL-ja ndan rreth 4.35 milionë euro për komunat

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 PRILL - Të mërkurën është mbajtur takimi i Komisionit të Grantit të Performancës Komunale në përbërje të përfaqësuesve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë, Agjencisë Suedeze, Ambasadës Norvegjeze, Zyrës Kombëtare të Auditimit, BIRN dhe INPO. Takimi i Komisionit të Grantit është hapur dhe kryesuar nga zëvendësuesi i sekretarit të përgjithshëm të MAPL-së, Trim Berisha, ndërkaq në fjalën hyrëse u adresua ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, i cili ka theksuar se ndarja e grantit për komunat



është e një rëndësie të veçantë, duke marrë parasysh nevojat e komunave si dhe ngritjen e performancës komunale për ofrimin e shërbimeve sa më të mira dhe më cilësore për

qytetarët.

Gjithashtu, ministri Krasniqi ka potencuar se tani është koha adekuate që ta rrisin bashkëpunimin me donatorët dhe aktorët e përfshirë.

Mbështetja e MAPL-së do të jetë e vazhdueshme dhe në pajtueshmëri me donatorët. Drejtoresha e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë, Katharina Stocker, ka theksuar

se ky takim dëshmon përkushtimin e përbashkët të të gjitha palëve me qëllim që të kemi një proces transparent dhe të qëndrueshëm.

Në këtë takim nga Komisioni Teknik u prezantua raporti i rivlerësimit të performancës komunale 2019, i cili, pas diskutimit të përbashkët nga të pranishmit, u aprovua në parim nga Komisioni i Grantit të Performancës.

Pas aprovimit në parim të raportit, të gjitha komunat do të njoftohen me rezultatet e tyre, ndaj të cilave mund të parashtrijnë ankesë brenda shtatë ditëve.

Me përmbylljen e këtij procesi, do të nënshkruhen marrëveshjet e mirëkuptimit me komunat përfituese në vlerë të përgjithshme 4,350,000. euro, për projekte kapitale në dobi të qytetarëve.

Ambasadori i ShBA-së ofron përkrahje për FSK-në



Prishtinë, 14 prill (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett.

Ky i fundit ka uruar ministrin Mehaj për detyrën e drejtimit të kësaj ministrie, duke i shprehur vullnetin e tij për bashkëpunim

në të ardhmen.

Ambasadori Kosnett ka premtuar se ShBA-ja përmes bashkëpunimit me Armatën e ShBA-së, Gardën Kombëtare të Ajovës dhe programeve të tjera, sikur edhe deri më tash, do ta vazhdojë partneritetin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-

në.

Ministri Mehaj ka shprehur falënderimin për vizitën duke theksuar mirënjohjen e thellë për ShBA-në për mbështetjen e pazëvendësueshme për vendin tonë si dhe në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e gjithëmbarshtëm të Ministrisë së

Mbrojtjes dhe FSK-së.

Ai, gjithashtu, theksoi se mbështetja e deritashme e ShBA-së ka qenë jetike për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme me forcat aleate të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s, që u kurorëzua edhe me

pjesëmarrjen e kontingjentit të parë të FSK-së në misionin e parë jashtë vendit së bashku me forcat ushtarake amerikane.

Në fund, të dy ishin të një qëndrimi që të shtohet edhe më tej bashkëpunimi bilateral në mes dy vendeve partnere në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Kërcënohet prokurori Naim Abazi



PRISHTINË, 14 PRILL (ER) - Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë dënuar kërcënimin ndaj prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Naim Abazi që, sipas tyre, vjen si rrjedhojë e veprimeve të ndërmarra nga ai gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare si prokuror.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka njoftuar se kanosja ndaj prokurorit Abazi është duke u trajtuar me prioritet dhe

seriozitet të lartë nga Prokuroria Themelore në Prishtinë në mënyrë që kërcënuesi sa më parë ta marrë dënimin e merituar. "Më këtë rast, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit qëndron afër të gjithë prokurorëve duke iu ofruar mbështetjen e plotë për punën dhe përkushtimin e tyre për ushtrimin e funksionit kushtetues dhe ligjor për hetimin dhe ndjekjen e të gjithë kryeseve të veprave penale. Po ashtu, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

siguron opinionin dhe qytetarët se kërcënimet ndaj prokurorëve nuk do t'i zmbropsin asnjë hap dhe në asnjë mënyrë përpjekjet tona të vazhdueshme për forcimin e shtetit ligjor", thuhet në reagimin e zyrës së kryeprokurorit të shtetit.

Edhe Këshilli Prokurorial i Kosovës ka theksuar se kërcënimin ndaj prokurorit Abazi është i plotësisht i papranueshme dhe ka për qëllim pengimin në ushtrimin e funksionit të tij kushtetues dhe ligjor.

Osmani, Mehaj dhe Rama në takim të përbashkët koordinues për çështje të mbrojtjes

PRISHTINË, 14 PRILL (ER) - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim koordinues për çështje të mbrojtjes ministrin e Mbrojtjes, Armend Mehaj, dhe komandantin e Forcave të Sigurisë së Kosovës,

gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i FSK-së njoftuan presidenten Osmani lidhur me zbatimin e programeve ekzistuese të ngritjes së kapaciteteve të FSK-së dhe mbështetjes së

ofruar nga shtetet mike. Presidentja Osmani ka theksuar rëndësinë e realizimit të planit të tranzicionit sipas standardeve të NATO-s, si dhe realizimin e synimit strategjik të Kosovës që të bëhet anëtare e kësaj aliance.



OAK-u kërkon përkrahje për Ligjin për pushimin e lehonisë dhe arkën "Patriot"

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 PRILL - Ofrimi i përkrahjes dhe kontributit profesional, përkrahja dhe kontributi i përbashkët për finalizimin e Ligjit të Punës dhe Ligjit për pushimin e lehonisë, kërkesa për krijimin e arkës "Patriot", ku çdo produkt vendor subvencionohet me 10 për qind ulje nga TVSh-ja, harmonizimi i vendimeve që lëshohen nga ATK-ja dhe Dogana e Kosovës lidhur me lirim e lëndës së parë për prodhuesit, e informimi lidhur me anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Indeksin Global të Konkurrueshmërisë, në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror ishin qëllimi i takimit të përfaqësuesve të OAK-së me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati.

Nënkryetari i OAK-së, Arsim Selmonmusaj, ka uruar ministrin Murati për detyrën e re dhe u shpreh i hapur për ofrimin e bashkëpunimit dhe ndihmës së OAK-së në aspektet profesionale. Ai ka kërkuar përkrahje, në veçanti rreth lobimit për ndryshim plotësimin e Ligjit të Punës dhe Pushimit të Lehonisë, si dy nga ligjet më esenciale. Ndërsa sekretari i OAK-së, Diamant Elshani, ka theksuar rëndësinë dhe kontributin që mund të japin nëse oda dhe sektori privat përfshihen në vendimmarrje duke qenë pjesë aktive e diskutimeve dhe grupeve punuese.

Ndër të tjera, gjatë këtij takimi u diskutua që TVSh-ja të paguhet brenda vendit në inkasim dhe jo në faturim. Gjithashtu, u diskutua edhe për problemet e bizneseve me bankat komerciale, lirimi i



plotë i lëndës së parë dhe pajisjeve për prodhim, rëndësia që koordinimi mes institucioneve dhe bizneseve të jetë continual në mënyrë që fuqia punëtore të jetë në përputhje me nevojat e tregut

si dhe të aplikohet mësimi dual për nxënësit si kombinim mes teorisë dhe praktikës në mënyrë që nxënësit të jenë sa më të përgatitur për tregun e punës. Ministri Murati, duke

falënderuar përfaqësuesit e OAK-së për ngritjen e këtyre temave, është shprehur i hapur për bashkëpunim, me qëllim që së bashku të evidentohen dhe tejkalohen sfidat të cilat hasen gjatë operimit të sektorit privat.

Së shpejti skadon afati për mosbllokimin e llogarive bankare nga ATK-ja



PRISHTINË, 14 PRILL - Me qëllim të zbatimit të vendimit nr. 04/60 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, datë 27.01.2021, për lehtësimin e ushtrimit të aktivitetit ekonomik të të gjithë tatimpaguesve, si pasojë e gjendjes së vështirësuar ekonomike të krijuar nga pandemia Covid-19, Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar të gjithë tatimpaguesit që kanë obligime tatimore të pashlyera se

mosbllokimi i llogarive bankare të tyre do të jetë i mundur vetëm deri më datë 30.04.2021. Pas datës 30.04.2021, për të gjithë tatimpaguesit që kanë obligime tatimore të pashlyera, Administrata Tatimore e Kosovës do t'i zbatojë procedurat e përcaktuara me legjislacionin tatimor në fuqi. "Të gjithë tatimpaguesve që kanë obligime tatimore të pashlyera, Administrata Tatimore u mundëson që të parashtrajnë

kërkesë për lidhjen e marrëveshjes për pagesën me këste të obligimeve tatimore nëse dëshmojnë se kanë vështirësi financiare për t'i përmbushur obligimet për shkak të situatës së pandemisë së shkaktuar si pasojë e Covid-19. Ndërsa për të gjithë tatimpaguesit të cilët nuk kanë vështirësi financiare, Administrata atimore, inkurajon që sa më shpejt t'i përmbushin detyrimet tatimore", ka njoftuar ATK-ja.

Inicohet procedura për auditimin e raporteve financiare të fushatës së subjekteve politike



Prishtinë, 14 prill (ER) - Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, me ç'rast ka iniciuar procedurat lidhur me auditimin e raporteve vjetore financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Po në këtë mbledhje anëtarët e këtij komisioni kanë miratuar edhe planin e punës. Sipas kryetares

së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Hykmete Bajrami, me iniciimin e tyre parashihet hapja e tenderit për kontraktimin e dhjetë auditorëve që do të merren me auditimin e këtyre raporteve. Bajrami ka treguar se ky proces ka dështuar në dy vjetët e kaluar për shkak të mosinteresimit të operatorëve që, sipas saj, një ndër arsytet për një gjë të tillë ka qenë buxheti i vogël.

Dogana kap mbi 28 000 mijë euro në një automjet

PRISHTINË, 14 PRILL (ER) - Në pikëkalimin kufitar të Hanit të Elezit janë kapur mjete monetare të padeklaruara të cilat përmes një automjeti të

udhëtarëve kanë tentuar të hyjnë në Kosovë pa deklarim. "Një automjet që vinte nga Maqedonia është sekuestruar për kontroll dhe gjatë

kontrollit të hollësishëm në anën e djathtë në sirtar janë hasur tri qese dhe pas hapjes së tyre janë gjetur mjete monetare të padeklaruara në

vlerë totale prej 28 310.00 eurosh. Të gjitha mjetet janë konfiskuar si dhe rasti ka vazhduar për hetime të mëtejme", ka njoftuar Dogana.





EURO GLASS
 eg
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Ylli fiton Ligën Unike

Prishtinë, 14 prill - Golden Eagle Ylli ka fituar Ligën Unike, duke mundur në finale Pejën 79:82 (27:19, 14:19, 22:28, 14:16). Ndeshja ishte mjaft interesante, ku Peja e nisi furishëm, duke pasur epërsi deri në 12 pikë në çerekun e parë 27:15, derisa kjo pjesë përfundon 27:19. Ylli nuk dorëzohet dhe pesë nga minuta nga fillimi i periodes së dytë, ngushton shifrat në 34:33. Më pas zhvillohet lojë e baraspeshuar, kurse pjesa e parë përfundon 41:38. Skuadra nga Theranda vazhdoi me lojë të mirë edhe në periodes të tretë, duke afruar shifrat dhe duke kaluar në epërsi 59:60, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 65:66. Lojë shumë interesante u zhvillua në periudhën e fundit, ku luftohej për çdo top në parket. 10 e fundit ishin shumë interesant dhe dramatik, me rikthime të shumta në rezultat dhe një lojë spektakolare. Dueli u vendos në sekondat e fundit, ku Ylli triumfoi 79:82. Te



Peja u dalluan Aj Walton me 25 pikë e 10 kërcime, Brandon Walters me 16 pikë e 12 kërcime dhe Laron Dendy me

15 pikë e 9 kërcime, kurse te Ylli u dalluan Erjon Kastrati me 21 pikë, Gëzim Morina me 15 pikë e 13 kërcime dhe Mitchell

Wilbekin me 18 pikë. Erjon Kastrati u zgjodh MVP i finale. Ky ishte trofeu i parë në histori të klubit për Yllin. Në ndeshjen

për vendin e tretë të Ligës Unike, Rahoveci ka shënuar fitore ndaj Goga Basket 81:74 (25:21, 16:19, 22:17, 18:17). Vreshtarët e nisën më mirë ndeshjen, duke pasur epërsi konstante në çerekun e parë, ku epërsinë më të lartë e kishte 25:18, derisa kjo pjesë përfundon 25:21. Në periodes e dytë më të mirë ishin durrësakët që jo vetëm barazuan rezultatin, por edhe kaluan në epërsi 33:36, kurse skuadrat shkuan në pushim me shifrat 41:40. Rahoveci sërish shkëputet në periodes e tretë, 61:51, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 63:57. Goga Basket tentoi në fund që të rikthehet, por nuk ia arriti qëllimit dhe Rahoveci triumfoi 81:74. Te Rahoveci u dalluan Marvin Jones me 25 pikë, Ed Daniel me 16 pikë e 11 kërcime dhe Altin Morina me 13 pikë e 11 kërcime, kurse te Goga Basket u dalluan Endrit Hysenagolli me 20 pikë e 13 kërcime dhe Milic Blagojeviq me 22 pikë e 10 kërcime.

Grabovci: Ku mbetën rreth 500 mijë euro për stadiumin 'Shahin Haxhiislami' në Pejë?

Prishtinë, 14 prill - Ish-zëvendësministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Arbër Grabovci, në një shkrim publikuar në profilin e vet në "Facebook", ka reaguar për gjendjen e stadiumit "Shahin Haxhiislami" në Pejë, për punimet e të cilit janë paguar rreth 500 mijë euro dhe stadiumi ka mbetur një gërmadhë. Grabovci ka kërkuar një hetim edhe nga Policia e Kosovës dhe Prokuroria. "Ku mbetën rreth 500 mijë euro për stadiumin 'Shahin Haxhiislami' në Pejë. Në vitin 2017, me një solemnit plot pompozitet, u filluan punimet për ndërtimin e tribunës perëndimore. Kontrata ishte në

vlërë prej 687 308 dhe punimet duhet të kryeshin për 36 muaj. Pas pesë vjetësh gjendja e stadiumit ka mbetur një gërmadhë, siç shihet edhe në foto. Përveç që nuk u mbajt premtimi, pyetja që do gjithsesi përgjigje është ku mbetën 445 969 të dhëna operatorit dhe PSE iu dhanë kur punimet nuk u kryen? Punimet janë bërë vetëm nëntokë e pagesa i është bërë në vlerë prej 65 % të kontratës. Nëse jo Komuna e Pejës dhe Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit përgjigjen duhet ta gjejnë Policia dhe Prokuroria. Vitin e kaluar përsëri u promovuan fillimet e punimeve në stadiumin 'Shahin Haxhiislami'

nga ministria dhe komuna ku theksuan se do të investohen 9 milionë euro, por 500 mijë euro të ndara vitin e kaluar nuk u shpenzuan fare, ndërsa që për vitin 2021 në buxhet nuk u nda asnjë cent. Stadiumi mbeti gërmadhë, ndërsa 445 969 u dhanë. A mund të quhet kjo qeverisje e mirë? Këtë çështje të ndeshme disa herë e kam ngritur edhe në asamble dhe nuk do të ndalem deri në zgjidhjen e problemit dhe ndëshkimin e faktorëve që sollën stadiumin në këtë gjendje të mjerueshme dhe paratë i dhanë pa i kryer punimet", ka shkruar Grabovci në profilin e vet në "Facebook".



Reali dhe City kualifikohen në gjysmëfinale

Dortmund, 14 prill - Real Madrid dhe Manchester City janë dy skuadrat e radhës që sigurojnë një biletë për në gjysmëfinalen e këtij edicioni në Champions League. "Los Blancos" administroi mjaft mirë fitoren 3-1 të ndeshjes së parë, duke barazuar pa gola në duelin e kthimit. Në "Anfield Road" emocionet ishin të mëdha, teksa Salah shpërdoroi një mundësi mjaft të mirë që në minutën e 3-të. Tetë minuta më

pas James Milner u ndal nga një pritje fantastike e Courtois. Në fundin e fraksionit të parë ishin sërish Salah dhe Wijnaldum, që nuk konkretizuan mundësitë për shënim. Në krahun tjetër Benzema do të ndalej nga shtylla pas një devijimi. Edhe në fraksionin e dytë asgjë nuk ndryshoi me Firminon dhe Vinicius Junior që krijuan dy rastet më të pastra. Manchester City ndërkohë mori një tjetër fitore 2-1 me

përmbysje kundër Dortmundit, edhe në Gjermani. Verdhezinjtë kaluan në avantazh në minutën e 15-të me talentin 17-vjeçar Bellingham, por City do të kundërpërgjigje në fraksionin e dytë. Mahrez nga pika e bardhe dhe Phil Foden përmbysën gjithçka, duke siguruar kualifikimin. Në gjysmëfinale City do të sfidojë PSG, ndërkohë që në



krahun tjetër Reali do të sfidojë Chelsea.

Fury: Lufta me Joshuan do të ndodhë

LONDËR, 14 PRILL - Tyson Fury ka thënë se lufta e shumëpritur mes tij dhe Anthony Joshuas do të ndodhë 100 për qind dhe se data dhe vendi do të bëhen të ditura në ditët në vijim. Përfaqësuesit e dy boksierëve britanikë janë duke i vlerësuar ofertat e bëra nga vendet që

dëshirojnë ta organizojnë meçin e madh. Por kampioni i botës në kategorinë e rëndë në WBC, Fury, paralajmëroi: "Nëse nuk marr vesh diçka deri të martën, do të largohem". "Gjithmonë kam qenë skeptik për gjithë këtë. Më kanë thënë se i kemi disa oferta të mëdha në tavolinë,

prandaj jam shumë i interesuar dhe mezi pres të dëgjoj se çfarë kanë për të na thënë ata", ka shtuar ai. "Mendoj se lufta do të ndodhë 100 për qind. Një milion për qind. Mendoj se në dy ditët në vazhdim do ta kuptojmë se ku dhe kur", ka deklaruar ai. Fury rrezikon ta humbasë

titullin në WBC, ndërsa Joshua rrezikon t'i humbasë titujt në IBF, WBO dhe WBA në luftën e parë për të gjithë katër titujt e mëdhenj të botës në kategorinë e rëndë. Kampioni i fundit i padiskutueshëm i botës ishte Lennox Lewis nga Britania e Madhe nga viti 1999 deri më 2000.



Utah u rikthehet fitoreve, triumfojnë clippersat dhe lakersat

CHARLOTTE, 14 PRILL - Vetëm 24 orë pas humbjes ndaj Washington Wizardsit, Utah Jazzi është rikthyer te fitorja, pasi këtë herë ka mposhtur me shifrat 106-96 Oklahoma City Thunderin në sfidën e zhvilluar në "Salt Lake City". Miqtë nga Oklahoma e nisën vullshëm ndeshjen falë edhe një forme të përkryer të kanadezit Luguantz Dort, i cili e mbylli ndeshjen me 42 pikë, 7 asistime dhe 3 rikuperime, megjithatë Utah reagoi mirë në fraksionin e dytë dhe të tretë, duke dominuar plotësisht dhe marrë kryesimin e lojës, të cilin e mbajti deri në fund. Vijon të bëjë mirë edhe Los Angeles Clippersit, që triumfoi me shifrat 115-126 në transfertën ndaj Indiana Pacersit, duke regjistruar fitoren e gjashtë radhazi këtë sezon. Në tre fraksionet e para sfida ishte e balancuar, ndërsa Clippersit bën diferencën vetëm në pjesën e fundit, duke blinduar suksesin, raporton "SS". Paul George ishte më i miri i ndeshjes me 36 pikë të shënuara, 7 asistime dhe 8 rikuperime, ndërsa për vendasit e Indianës spikatën Brogdon dhe



Levet, që gjithsesi nuk ia dolën ta shmangin humbjen e Pacersit. Ndonëse pa yjet LeBron James dhe Anthony Davies, të cilët vijojnë të jenë të dëmtuar, Los Angeles Lakers ia ka dalë të marrë një tjetër sukses, këtë herë në transfertën ndaj Charlotte Hornetsit me shifrat 93-101. Edhe ky takim ishte i balancuar dhe i luftuar shumë nga të dy skuadrat, por kalifornianët ia dolën ta bëjnë diferencën në fraksionin e tretë, falë formës së mirë të Kyle Kuzma dhe gjermanit Denis Schroder. Fitore pa shumë mundim për Phoenix

Suns, që ia doli të triumfojë me shifrat 106-86 në sfidën përballë Miami Heatsit. Këta të fundit e nisën vullshëm fraksionin e parë të ndeshjes, por më pas ishin vendësit që morën kontrollin e lojës dhe dominuan totalisht deri në fund, duke regjistruar edhe suksesin e katërt radhazi. Në sfidat e tjera, Boston Celticsi ia doli të fitojë me rezultatin e ngushtë 115-116 në transfertën ndaj Portland Trail Blazersit, ndërsa Atlanta Hawksit triumfoi me shifrat 103-108 në transfertën ndaj kanadezëve të Toronto Raptorsit.

Sot finalja Bashkimi - Penza

PRISHTINË, 14 PRILL - Finalja e "play-off"-it në EBC Ligën e Femrave do të zhvillohet ndërmjet Bashkimit dhe Penzës. Vashat pejane në një ndeshje dramatike kanë mundur Prishtinën me rezultat 87:86. Për fitoren është vendosur në sekondat e fundit. Skuadra pejane kishte fituar edhe përballjen e parë dhe kështu siguroi finalen e madhe pas shumë viteve dhe do të përballet me Bashkimin. Te Penza u dallua kapitenia Valbona Bytyqi me 34 pikë e shtatë kërcime, ndërsa te Prishtina u dalluan Enxhi Khanaj me 22 pikë e 9 asistime dhe Enisa Kamerolli me 25 pikë.

Bashkimi mundi edhe në



ndeshjen e dytë Vëllaznimit 84:105, duke siguruar finalen. Të Vëllaznimit u dallua Raven Baker me 37 pikë dhe 10 asistime, ndërsa te Bashkimi u dalluan Aisha

Balarabe me 44 pikë dhe 24 kërcime dhe Saranda Daci me 35 pikë, 18 kërcime dhe 10 asistime. Finalja e parë do të zhvillohet të enjten nga ora 19:00.

Mourinho mund të shkarkohet, Sarri shihet si pasardhës

Humbja kundër Manchester Unitedit në kampionat mund t'i ketë kushtuar shtrenjtë Jose Mourinhos. Trajneri portugez dhe Tottenhami tashmë e shohin me dylbi mundësinë e

kualifikimit për në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm, aq më tepër pasi u eliminuan në mënyrë të turpshme edhe nga Liga e Evropës, e cila ishte edhe rruga

më e shkurtër drejt një vendi në kompeticionin më të rëndësishëm për klube. E gjithë kjo ka bërë që në fund të këtij sezoni të dyja palët t'i thonë lamtumirë njëri-tjetrit, me

Tottenhamin që ka vënë në krye të listës së dëshirave ish-trajnerin e Juventusit. Bëhet fjalë për Maurizio Sarrin, i cili, pasi fitoi me Chelsea Ligën e Evropës dhe me bardhezinjtë

kampionatin, shihet si një kandidat shumë i fortë për të pasuar Mourinho. Nga ana tjetër, Jose do të ngushëllohet me 36 milionë euro që i takojnë nga kontrata deri në vitin 2023.

SHKURT

Neymari konfirmon rinovimin e kontratës me PSG-në

Sulmuesi brazilian Neymar ka bërë me dije se së shpejti do ta rinovojë kontratën me skuadrën e Paris Saint-Germainit. Neymari ka thënë se po ndihet mirë te ekipi francez dhe për këtë arsye do të vazhdojë të mbetet pjesë e tij edhe për disa vjet. Sulmuesi brazilian ka kontratë me PSG-n deri vitin tjetër, kurse pas rinovimit do të jetë pjesë e klubit të paktën deri në vitin 2024. "Rinovimi i kontratës me PSG-në, më nuk është çështje. Përfundimisht, ndihem shumë mirë këtu si në shtëpinë time. Jam më i lumtur se më parë", është shprehur 29-vjeçari. Braziliانى është pjesë e ekipit nga Ligën 1 prej vitit 2017 kur iu bashkua nga Barcelona për një dëmshpërbllim rekord prej 222 milionë eurosh. Këtë sezon Neymari ka shënuar 13 gola dhe ka bërë tetë asistime në 22 paraqitje në të gjitha garat.

Poirieri dhe McGregori do të ballafaqohen më 10 korrik

UFC-ja ka konfirmuar që meçi i tretë i shumëpritur mes Dustin Poirierit dhe Conor Mc Gregorit do të mbahet. Ishte irlandezi që para dy ditëve përmes një postimi në rrjetin social "Twitter" njoftoi se nuk do të përballet me Poirierin. Mirëpo, sot (e mërkurë), UFC-ja në "Twitter" ka konfirmuar që të dyja palët kanë nënshkruar marrëveshjen dhe përballja e tretë do të zhvillohet më 10 korrik 2021. "Është nënshkruar. Dustin Poirier kundër Conor Mc Gregor 3 është zyrtare për UFC 264 në Las Vegas", shkruhet edhe në njoftimin që e ka bërë UFC-ja në "Facebook".

Barça dhe Juve në garë për Agueron

Sergio Agueron do të jetë një prej më të nxehtëve në merkaton e verës. Sulmuesi argjentinas në fund të sezonit do të lërë Manchester Cityn dhe iu pëlqen disa prej klubeve më të mirë të Evropës, mbi gjithë të tjerëve Barcelonës dhe Juventusit. Klubi katalanas në fakt nuk ka aspak ndër mend t'i garantojë Agueron 12 milionë eurot në sezon që merr aktualisht te Manchester City, por një pagë shumë më të ulët në një kontratë me bazë fikse. Sipas mediave spanjolle, klubi që ka shfaqur interes më të madh është Juventusit. Objektivi i klubit bardhezi, sipas të përditshmes "Sport", është ai për të lënë të lirë Ronaldon dhe për të bërë dy blerje të reja në sulm, një prej të cilëve është Agueron.

De Rossi largohet nga spitali

Pas katër ditësh trajtimi mjekësor Daniele De Rossi ka lënë spitalin dhe është rikthyer në shtëpinë e tij, në pritje të një tamponi negativ të koronavirusit. Ish-mesfushori italian ishte prekur nga koronavirusi dhe situata u komplikua, ndaj më 9 prill u shtrua në një klinikë private në Romë, megjithatë mjekët kanë garantuar një gjendje të mirë të De Rossit, që është rikthyer në shtëpinë e tij. Në muajin mars ish-mesfushori italian u bë pjesë e stafit të Roberto Mançinit në kombëtaren italiane dhe gjatë grumbullimit për eliminatorët e Katar 2022 është prekur nga koronavirusi ashtu si shumë të tjerë. Kombëtarja italiane u shndërrua në një vatër të koronavirusit gjatë muajit mars, pasi u infektua 12 futbollistë dhe disa pjesëtarë të stafit teknik të Roberto Mançinit.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Asistent/e Ekzekutiv/e

Departamenti: Zyra e Koordinatorit të Funksioneve të Përgjithshme

Niveli i gradës: 7

I raporton: Koordinatorit të Funksioneve të Përgjithshme

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Menaxhon funksionimin e mirë të Zyrës së Koordinatorit të Funksioneve të Përgjithshme, ofron mbështetje të plotë administrative, sekretarie dhe logjistike me shkallën më të lartë të konfidencialitetit;
- Mbështet nevojat administrative; si organizimi efikas i kalendarit të punës (pranon, verifikon dhe orienton vizitorët dhe thirrjet telefonike, mban në mënyrë sa më precize agjendën e Koordinatorit të Funksioneve të Përgjithshme, përditëson atë dhe informon paraprakisht, cakton prioritetet për kërkesat për takime;
- Kryen të gjitha funksionet administrative; organizon planin ditor të punës; mirëmban vijueshmërinë e shkresave në mënyrë efikase dhe konfidenciale;
- Mbulon të gjitha detyrat administrative si printimet, fotokopjimet, skanimet etj;
- Aranzhon udhëtimet, akomodimin si dhe koordinohet me institucionet nikoqire për vizitat zyrtare të Koordinatorit të Funksioneve të Përgjithshme;
- Detyra tjera të ngjashme të caktuara nga mbikëqyrësja.

Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë universitare nga fusha e ekonomisë, drejtësisë, financave, komunikimit ose të tjera,
- Njohje e rrjedhshme në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe. Njohja e gjuhës angleze është e preferuar.
- Njohja e mirë e MS Office;

Kërkesat e veçanta:

- Aftësi që të punojë në ekip si dhe në mënyrë të pavarur me një mbikëqyrje të vogël;
- Aftësi për të punuar në një mjedis me diversitet programor;
- Gatishmëri që krahas punës me një orar të ngjeshur të reflektojë fleksibilitet dhe proaktivitet të theksuar në realizimin me kompetencë dhe konfidencë të agjendës së Zyrës së Koordinatorit të Funksioneve të Përgjithshme.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 prill 2021**.
- Aplikimi mund të bëhet on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr:8. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org.
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Pozicija: Izvršni asistent/kinja

Odeljenje: Kancelarija koordinatora za opšte funkcije

Nivo stepena: 7

Izveštava: Koordinator za opšte funkcije

Dužnosti i odgovornosti:

- Upravlja pravilnim funkcionisanjem Kancelarije koordinatora za opšte funkcije, pruža punu administrativnu, sekretarsku i logističku podršku uz najviši stepen poverljivosti;
- Podržava administrativne potrebe; kao što je efikasno organizovati kalendar rada (prima, proverava i usmerava posetioce i telefonske pozive, što tačnije održava dnevni red Koordinatora opštih funkcija, ažurira ga i unapred obaveštava, postavlja prioritete za zahteve za sastanke;
- Obavlja sve administrativne funkcije; organizuje dnevni plan rada; održava doslednost dokumenata efikasno i poverljivo;
- Obuhvata sve administrativne zadatke kao što su štampanje, fotokopiranje, skeniranje itd .;
- Dogovara putovanja, smeštaj i koordinira sa institucijama domaćinima za zvanične posete Koordinatora opštih funkcija;
- Drugi slični zadaci koje dodeljuje nadzornica.

Potrebno znanje:

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava, finansija, komunikacija ili drugo,
- Tečno govori i piše albanski i / ili srpski jezik. Poželjno je znanje engleskog jezika.
- Dobro poznavanje MS Office-a;

Posebni zahtevi:

- Sposobnost rada u timu, kao i samostalno uz malo nadzora;
- Sposobnost rada u okruženju sa programskom raznolikošću;
- Spremnost za rad sa vrlo zauzetim rasporedom koji odražava fleksibilnost i proaktivnost koja se ističe u kompetentnom i poverljivom sprovođenju dnevnog reda Kancelarije koordinatora za opšte funkcije.

Svi kandidati treba da dostave sledeće dokumente:

- Službeni obrazac aplikacije CBK;
- Propratno pismo (motivacijsko) u kome se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo MONT mora zvanično priznati / nostrifikovati;
- Dokaz o identitetu i prebivalištu na Kosovu.

Aplikacija postupak:

- Rok za prijavu je **29. april 2021. godine**
- Prijava se može izvršiti na mreži (<https://hris.bqk-kos.org>) putem zvanične veb stranice CBK ili putem arhive CBK, br: 8. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti razmatran.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti sa zvanične veb stranice: www.bqk-kos.org.
- Nepotpuna dokumentacija neće biti uzeta u obzir.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Shpejtim Karce shpall te pavlefshëm diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

- ▶ Franc Pergjoka shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

- ▶ Seit Sabani shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- ▶ Urgjentisht kërkoh një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtarie filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzgjenezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

AGRON SHALA

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚŁOWSKI

DEKALOGU

『 nga Moisiu deri te Kieślowski 』

ÇMIMI: 5.99 €



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

